

STATUTI I SHOQËRISË
"MEDIA KONCEPT" SH.P.K.

Sot, më datë 16.12.2019 (dymjë e nëntëmbëdhjetë), në mbështetje të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe të Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", personat e mëposhtëm vendosën të formojnë shoqërinë sipas termave në vijim:

KREU 1
THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI 1
DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

1. Sot ne date 16.12.2019, u themelua shoqeria me perjegjesi te kufizuar me emrin "**MEDIA KONCEPT**" SH.P.K.
2. Themelueset e shoqerisë:
 - **Erida Shani**, atësia Aristidh, e lindur më 15.08.1980 në Fier dhe banuese në Tiranë, madhore me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, e identifikuar me kartë identiteti me nr. 029874027 dhe nr.personal I05815103J
 - **Karolina Rista**, atësia Perikli, e lindur 05.04.1979 në dhe banuese në Tiranë, madhore me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, e identifikuar me kartë identiteti me nr. 034699066 dhe nr.personal H95405200G.

NENI 2
OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kësaj shoqerie do të jetë:

Kompania ka për objekt:

- Ofrimin e shërbimeve në fushën e prodhimit dhe realizimit te produkteve audio vizuale.
- Realizimin e spoteve, dokumentareve, reportazheve, videoeve etj
- Organizimin e konferencave, seminareve, trajnimeve apo aktiviteteteteve te tjera te ketij lloji.
- PR, marketing, vizibilitet sipas kerkesave te kontraktuesve
- Realizimin e sondazheve, monitorimeve, studimeve etj
- Ngritje e kapaciteteve mediatike, profesionale etj sipas kerkesave te kontraktuesve.
- Fushata publicitare, ndergjegjesuese, promovuese etj sipas kerkesave te kontraktuesve.
- Realizimin e eveneteve te cdo lloji.
- Trajnine, rrjetezime, aftesimeve profesionale etj.
- Konsulence, ideim dhe brendim sipas kerkesave te kontraktuesve

Per te gjitha aktivitete qe kerkojne licenca te veçanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI 3
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pacaktuar.

NENI 4
SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Rruga "Skënderbej", Ndërtesa 31/1 Tiranë .

KREU II
KAPITALI

NENI 5
KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete **100 (njëqind)** leke i perbere nga 2 kuota.

Pjesëmarrja e ortakeve themeluese në kapitalin e shoqërisë do të jetë:

Kontributi ne kapitalin e shoqerise zoterohet ne masen 50% nga Ortakja:

- **Karolina Rista**, atësia Perikli, e lindur 05.04.1979 në Durrës dhe banuese në Tiranë, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, e identifikuar me kartë identiteti me nr. 034699066 dhe nr.personal H95405200G.

dhe 50% nga Ortakja:

- **Erida Shani**, atesia Aristidh, e lindur më 15.08.1980 në Fier dhe banuese në Tiranë, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, e identifikuar me kartë identiteti me nr. 029874027 dhe nr.personal I05815103J

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo të drejta).

NENI 6
ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asje rast shumica nuk mund te detyroje një ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin te regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI 7
TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
 - b) Shitblerjes
 - c) Trashegimise
 - d) Dhurimit
 - e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.
- Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8
ORGANET VENDIMMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e per gjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet si me poshte:

- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Ndryshimet e statutit
- c) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e) percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f) Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimitarise
- g) Miratimi i bilanceve
- h) Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i) Pjestimin e kuotave dhe annullimin e tyre
- j) Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k) Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l) Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqsues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme. Autorizimi mund te jetet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9
THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PER GJITHSHME

Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbate vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

NENI 10
KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi te permendur ne paragrafin e mesiperme nuk arrihet, asambleja e per gjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11
MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane **QKB** per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12 PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqsohet nga nje perfaqsues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13 ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emeron dy persona fizik si administratore te shoqerise qe mund te funksionojne edhe veç e veç. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte rizgjedhje mes ortakeve. Emerimi i administratoreve prodhon efekte ndaj të tretëve pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposhtem caktohen Administratorë të shoqerise:

- **Karolina Rista**, atësia Perikli, e lindur 05.04.1979 në dhe banuese në Tiranë, madhore me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, e identifikuar me kartë identiteti me nr. 034699066 dhe nr.personal H95405200G.
- **Erida Shani**, atësia Aristidh, e lindur më 15.08.1980 në Fier dhe banuese në Tiranë, madhore me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, e identifikuar me kartë identiteti me nr. 029874027 dhe nr.personal I05815103J

NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

- (1) Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratorët, të cilët mund t'i ushtrojnë të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asambesë së Përgjithshme nga neni 81 i Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- (2) Administratorët nuk mund të delegojnë asnjerën prej detyrimeve, të cilat i'u ngarkohen me ligj, **ndërsa mund të delegojnë kompetencat e tjera në përputhje me nevojat për t'i bërë ballë rasteve të pamundësisë objektive për të vepruar vetë apo rasteve të urgjencës.**
- (3) Administratoret kane te drejte dhe detyrohen të:
 - a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare ;
 - b) Perfaqesojne shoqerine;

- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise;
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimatrine e shoqerise;
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne çdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

Administratorret detyrohen te therrasin Asamblene e pergjithshme kur:

- a) Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b) Shoqëria propozon të shesë apo të disponoje në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- c) Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

NENI 15
PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte perjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Administratorret te cilet kane kryer veprime ose bere marrëveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane perjegjes per demet e sjella shoqerise dhe perjigjen personalisht ose solidarisht per pasojet.

Perveç sa eshte parashikuar ne nenet 14, 15, 17 dhe 18 te ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregetare”, administratorret detyrohen:

- a) Te kryejne detyrat e tyre te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjesdis;
 - b) Te ushtrojne kompetencat qe i njihen me ligj dhe statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto;
 - c) Te vleresoje me perjegjesi çështjet , per te cilat merret vendim;
 - d) Te parandaloje dhe evitoje rastet e konfliktit aktual o te mundshem te interesave te tij me ato te shoqerise;
 - e) Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.
2. Administratorret gjate kryerjes se detyrave te tij, perjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim apo mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregetare, me perjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
 3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga

kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

4. Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku kane te drejte te ngritjen e kerkese padise kunder administratorit. Asambleja nuk mund te marre vendim te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij .

**KREU IV
VITI FINANCIAR –EKSPERTET**

**NENI 16
VITI FINANCIAR**

Viti finaciar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtmisht , viti i pare finaciar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbylltet me 31 dhjetor.

**NENI 17
EKSPERTET**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregetare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar pergaat raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finaciar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara.

**KREU V
PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE**

**NENI 18
PRISHJA DHE LIKUDIMI I SHOQERISE**

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b) Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c) Me hapjen e procedurave te falimentit
- d) Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njofuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombatari et Regjistrimit,
- e) Me vendim gjykate.

**NENI 19
RIORGANIZIMI I SHOQERISE**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjt mbi shoqerite tregtare.

**NENI 20
LEGJISLACIONI**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe Ligjin nr.9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

**NENI 21
MOSMARREVESHJET**

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.

Ky akt u redaktua ne 1 (nje) kopje ne gjuhen shqipe dhe u nënshkrua me vullnet të plotë dhe të lirë nga ortaket themeluese te shoqërisë Erida Shani dhe Karolina Rista.

ORTAKET THEMELUESE

Ebbe Strom



Karoline Rist

